



DREJTUESI I PUNIMEVE

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KOMUNA KUKUR  
KRYETARI

Nr. 133 Prot.

Kukur me 24.09.2014

## K O N T R A T Ë

### P Ë R

**DREJTIMIN E PUNIMEVE PER OBJEKTIN: "RIKONSTRUKSION I SHKOLLES SE BASHKUAR "MUHARREM ZELA",KUKUR"**


Sot me date 24.09.2014 midis Komunes Kukur, Gramsh(INVESTITOR) e perfaqesuar nga Kryetari **z. Luan Kokla** dhe mbikqyresit te punimeve Shoqerise "A.SH.Engineering"shpk me numer **License MK 2463/1** ,perfaqesuar nga drejtuesi ligjor **z.Arian Shtembari** lidhet kjo kontrate sherbimi me objekt: "**Mbikqyrje e punimeve ne objektin "Rikonstruksion i shkolles se bashkuar "Muharrem Zela " Kukur"**

### Baza ligjore.

- 1 Ligji nr.8402 date 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit"kapitulli I III-te.
- 2 UKM nr.3 date 15.02.1001, ndryshuar me UKM nr.4 date 17.05.2001 "Per nje ndryshim ne UKM nr.3 date 15.02.2001 "Per mbikeqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit",ndryshuar me UKM nr.7 dt 21.11.2001,ndryshuar me UKM nr.1 date 16.06.2011.
- 3 VKM nr.444 date 05.09.1994"Per tarifat e studimit,projektimit,drejtimit dhe kolaudimit te veprave te ndertimit",i ndryshuar.
- 4 Dispozitat e Kodit te Procedurave Administrative ne lidhje me afatet , njoftimet,ankimet etj.
- 5 Dispozitat e Kodit Civil per siper marrjen.
- 6 Dokumentacioni administruar ne dosjen e zhvillimit te tenderit per objektin: : "**Rikonstruksion i shkolles se bashkuar "Muharrem Zela " Kukur"**  
**OBJEKTI I KONTRATES**

### NENI 1

Objekti i kontrates eshte mbikqyrja e punimeve nga Shoqeria "A.SH.Engineering"shpk me numer **License MK 2463/1** te caktuar ne objektin: : "**Rikonstruksion i shkolles se bashkuar "Muharrem Zela " Kukur"**



## **II. DETYRIMET E DREJTUESIT(MBIKQYRESIT)TE PUNIMEVE**

### **NENI 1**

Shoqeria “A.SH.Engineering”shpk me numer License MK 2463/1 si Drejtues (Mbikqyres) te punimeve ne objektin “Rikonstruksion i shkolles se bashkuar ”Muharrem Zela ” Kukur”mban pergjegjesi dhe pergjigjet per dokumentacionin tekniko-administrativ per realizimin e punimeve te sipermarrrjes ne objekt si licensa,kontrata,ditar objekti,libreze masash,certifikata materialesh,plan-organizimin e punimeve,procesverbalet e ndryshme ,etj

### **NENI 2**

-Ne castin e fillimit te punimeve Drejtuesi (Mbikqyresi)I punimeve duhet te beje verifikimin paraprak te gjithe dokumentacionit perkates,te licensave,te autorizimeve dhe te lejeve,verifikimin e sheshit te ndertimit,njohjen me hollesi te kontrates se sipermarrrjes dhe te gjithe akteve administrative qe lidhen me te,njohjen e te gjitha ndryshimeve te mundeshme te kesaj kontrate me kalimin e kohes.

### **NENI 3**

- Drejtuesi (Mbikqyresi) I punimeve harton aktin e dorezimit te sheshit te ndertimit ,lejes se ndertimit shoqerise sipermarrese,aktin e dorezimit nga sipermarresi te dokumentacionit teknik dhe administrative,si licensa,autorizime e leje te marra nga sipermarresi.

### **NENI 4**

Drejtuesi (Mbikqyresi) I punimeve,gjate zbatimit te objektit jep instruksione dhe urdhera me shkrim sipermarresit sa here qe e shoh te nevojshme ne zbatim te akteve ligjore e nenligjore dhe anes teknologjike te objektit ne funksion te kushteve dhe rrethanave specifike qe paracakton realizimi vepres.

### **NENI 5**

Drejtuesi (Mbikqyresi) I punimeve ka te drejte te propozoje largimin nga puna te nje ose disa personave nga personeli i sipermarresit,duke ju drejtuar me shkrim drejtuesit ligjor te sipermarresit,duke i shpjeguar arsyet.

### **NENI 6**

Materialet qe vijne ne kantier duhet te jene ne perputhje me kerkesat teknike te projektit,si dhe specifikimeve teknike te dhena ne dokumentat e tenderit.Materialet ne veper perdoren vetem me miratimin e Mbikqyresit te punimeve.

### **NENI 7**



Drejtuesi (Mbikqyresi) I punimeve ka te drejte te kerkoje certifikimin e materialeve ne original nga sipermarresi,si dhe te kerkoje kryerjen e provave te materialeve te vendosura ne objekt.Kur ato nuk jane vendosur ne cilesine dhe standartin e kerkuar te gjitha shpenzimet per keto prova perballohen nga sipermarresi.

#### NENI 8

Drejtuesi (Mbikqyresi) I punimeve ka te drejte te pezulloje perkohesishte punimet per zbatimin teknik te gabuar ose paaftesi teknike zbatimi ne cdo rast me miratimin e Titullarit te Autoritetit Kontraktor,per aq kohe sa quhet e nevojshme korigjimi i gjendjes.

#### NENI 9

E gjithë korespondenca e Drejtuesi (Mbikqyresi) te punimeve me investitorin dhe sipermarresin perben dokumentacionin e objektit dhe si e tille ruhet me cdo kusht ne dosjen e tenderit e cila duhet te dorezohet me procesverbal te rregullt ne arshiven e institucionit .

#### NENI 10

Drejtuesi (Mbikqyresi) I punimeve merr pjese ne kolaudimin e vepres e i pergjigjet kolaudatorit me te gjithë dokumentacionin e objektit dhe firmos procesverbalin e kolaudimit.

#### NENI 11

Situacionet e paraqitura nga sipermarresi ne fazat e ndryshme te punimeve kontrollohen dhe miratohen nga Drejtuesi (Mbikqyresi) i punimeve.Pagesa mund te kryhet vetem ne baze te ketij miratimi.Keto dokumenta dergohen ne seksionin e finances dhe ky i fundit i percjell per konfirmim tek Kryetari i Autoritetit Kontraktor,bashke me vertetimin e perkohshem te pageses per te shpallur vleren e detyrueshme per pagim.

#### NENI 12



Mbas perfundimit te kolaudimit, Drejtuesi (Mbikqyresi) i punimeve mbeshtetur ne kontraten dhe ne dokumentacionin tjeter,percakton vleren perfundimtare te objektit e cila i behet e ditur sipermarresit,si dhe i jepet per likuidim investitorit.

#### NENI 13

Drejtuesi (Mbikqyresi)i punimeve kontrollon dhe autorizon perdorimin e fondit reserve(nese ka ose mund te amplikohet shtese kontrate deri 20% sipas dispozitave ligjore ne fuqi) te kontraktuar,mbasi me pare ka marre miratimin nga investitori dhe raporton periodikisht per gjendjen e tij po tek investitori .

#### NENI 14

Drejtuesit (Mbikqyresi)i punimeve ka pergjegjesi per dorezimin e dosjes se zbatimit me inventar ne arshiven e institucionit dhe vetem pas dorezimit te saj lind detyrimi i investitorit per dhenien e shperblimit te caktuar ne kete kontrate.



### **III. DETYRIMET E INVESTITORIT**

#### **NENI 1**

- a)Ti jap dhe vere ne dispozicion te Drejtuesi (Mbikqyresi) te punimeve te gjithë dokumentacionin e zhvillimit te tenderit per objektin: **“Rikonstruksion i shkolles se bashkuar “Muharrem Zela ” Kukur”**
- b)Te njoftoje Drejtuesin (Mbikqyresi) e punimeve ditën kur do te dorezoje objektin per fillimin e punimeve.
- c)Te njoftoj Drejtuesin (Mbikqyresin) e punimeve per ditën kur grupi i ngritur enkas nga komuna do te marre ne dorezim punimet.
- d) Te shperbleje Drejtuesin e punimeve ne masen prej **34 000(tridhjetë e kater mije)leke pa Tvsh dhe 40 800(dyzetë mije e teteqind )leke, me TVSH,**sipas vleres se fituar ne tenderin BVV te zhvilluar me date 20.09.2014.

### **III. TE NDRYSHME**

#### **NENI 1**

- a)Kjo kontrate eshte ne funksion dhe do te behet aneks i kontrates se sipermarrrjes ,qe do te lidhet midis : **“Ndregjoni” sh.p.k dhe Komunes Kukur, Gramsh.**
- b)Jane pjese e kesaj kontrate dokumentacioni i kerkuar ne ftesen per oferte ne tenderin e zhvilluar me date 20.09.2014:
- Licensa profesionale te shoqerise
  - Ekstrakt QKR-je historik dhe te thjeshte.
  - Deklarate mbi gjendjen gjyqesore.
  - Formulari i cmimit te ofertes
  - IBAN dhe nr.llogarise bankare
- c)Komunikimi do te behet vetem me shkrim ai behet efektiv per komunën vetem pasi ai te jete protokolluar ne Librin e Korespodences se ketij institucioni
- d)Zgjidhja e mosmarreveshjeve behet me mirekuptim midis paleve e ne te kundert palet i drejtohen gjykates.

Kjo kontrate hartohet ne tre kopje te barabarta dhe pasi u gjend e bazuar ne ligj me vullnetin e lire te paleve firmoset si me poshte :

**KONTRAKTORI**  
**“A.SH.ENGINEERING”SHPK**  
**DREJTUESI LIGJOR**  
**ARIAN SHTEMBARI**



**PER AUTORITETIN KONTRAKTOR**  
**KRYETARI**  
**LUAN KOKLA**

